

Raport inxhiniero-teknik mbi gjëndjen problematike të banesave kolektive shumëkatëshe (pallateve), në territorin e qytetit Memaliaj.

Në zbatim të Urdhërit të Kryetarit, Nr. 62, prot. Date 02/06/2022, u krye verifikimi në vend i situatës në lidhje me dëmtimet e banesave kolektive (pallatet) në territorin e qytetit Memaliaj.

Nga verifikimet e kryera, grupi i punës, i miratuar me Urdhërin e sipërpërmendur, konstatoi dëmtime në tarracat e pallateve. Kryesisht, u konstatua tipologjia e dëmtimeve, si me poshte :

- Dëmtime të konstruksioneve mbajtëse në tarracat e pallateve.
- Dëmtime të shtresave hidroizoluese (karton katrama);
- Dëmtime të shtresës rrafshuese llac cimento (1:2);
- Dëmtime të parapeteve të tarracave.

Dëmtimi i elementeve të sipërpërmendur, të cilët sigurojnë hidroizolim të tarracave të pallateve, kanë sjellë për pasojë edhe dëmtimin e elementeve të tjerë ndërtimore konstruktive, p.sh. :

- Dëmtim i soletave të tarracave, deri në zbulimin e hekurit konstruktiv të tyre;
- Dëmtim i mureve në katet poshtë tarracave.

Dëmtimet e elementeve konstruktive kanë ardhur si rezultat i depërtimit të lageshtisë në tarraca, dhe me tej në muret dhe ambientet e tjera të brëndshme të kateve të sipërme të pallateve. Si rezultat, një pjesë e konsiderueshme e apartamente të kateve të sipërme (nën tarraca) janë praktikisht të papërshtatshme për banim.

Sa më sipër, grupi i punës arriti në përfundimin që, është emergjente ndërhyrja në tarracat e pallateve ku janë vërtet dëmtimet, pasi rrezikohet seriozisht jeta e banorëve rezidentë në këto pallate.

Konkretisht, ndërhyrja emergjente do të konsistojë në përforsimin e ekonstruksionit mbajtës të këtyre tarracave. Dëmtimi tarracave ka ndodhur

në vite ,për shkak të kushteve atmosferike ekstreme (bresheri I rënë në vitet e mëparsheme).

Nga verifikimet e kryera, u konstatuan dëmtime në tarracat e pallateve Duke u bazuar në parashikimet e punimeve hidroizoluese, që duhen kryer për hidroizolim e tarracave, si dhe në fondin që është në dispozicion, grupi i punës hartoi preventivin përkatës, kopja e të cilit i është bashkëngjitur këtij raporti.

Në preventiv, janë parashikuar punimet me shtresat, si vijon

- Shtresë llac cemento (1:2), t=4cm, mbi soletën e tarracës;
- Hidroizolim me emulsion 1-karton katrama importi (cilësi e parë);
- Shtresë llac cemento (1:2), t=4cm.
-

Punimet për hidroizolim e tarracave, janë parashikuar fillimisht në 14-pallate (sipas numeracionit të shënuar në planimetritë e pjeshme që janë përgatitur nga grupi i punës).

Specifikisht, punimet e sipërpermendura do të kryhen në tarracat pallateve, si më poshtë :

Në Pallatin nr.2, është parashikuar :

- Shtresë llac cemento 1:2, t=4cm (61m²);
- Hidroizolim me emulsion 1-karton katrama importi (cilesi e parë) (440m²);
- Shtresë llac cemento 1:2, t=4cm (405m²)

Në Pallatin nr.4, është parashikuar :

- Shtresë llac cemento 1:2, t=4cm (112m²);
- Hidroizolim me emulsion 1-karton katrama importi (cilësi e parë) (123m²);
- Shtresë llac cemento 1:2, t=4cm (202m²)

Në Pallatin nr.8, është parashikuar :

- Shtresë llac cemento 1:2, t=4cm (84m²);
- Hidroizolim me emulsion 1-karton katrama importi (cilesi e parë) (93m²);

- Shtresë llac cemento 1:2, t=4cm (740m²)

Në Pallatin ku banon shtetasi Gëzim Shehu, hyrja nr.2, është parashikuar :

- Hidroizolim me emulsion 1-karton katrama importi (cilesi e parë) (177m²);
- Shtresë llac cemento 1:2, t=4cm (167m²)

Në Pallatin nr.10, është parashikuar :

- Hidroizolim me emulsion 1-karton katrama importi (cilesi e parë) (284m²);
- Shtresë llac cemento 1:2, t=4cm (263m²);

Në Pallatin nr.19, është parashikuar :

- Hidroizolim me emulsion 1-karton katrama importi (cilesi e parë) (230m²);
- Shtresë llac cemento 1:2, t=4cm (214m²);

Në Pallatin nr.20, është parashikuar :

- Hidroizolim me emulsion 1-karton katrama importi (cilesi e parë) (230m²);
- Shtresë llaç çimento 1:2, t=4cm (214m²);

Në Pallatet nr.35/36/37/38/39, është parashikuar kryerja e punimeve në riparimin e shtresave hidroizoluese në tarracat që korrespondojnë me kafazet e shkallëve :

- Shtresë llaç çimento 1:2, t=4cm (305m²);
- Hidroizolim me emulsion 1-karton katrama importi (cilesi e parë) (335m²);
- Shtresë llaç çimento 1:2, t=4cm (305m²);

Në Pallatin nr.29, është parashikuar :

- Shtrese llaç cemento 1:2, t=4cm (213m²);
- Hidroizolim me emulsion 1-karton katrama importi (cilesi e parë) (234m²);
- Shtresë llac cemento 1:2, t=4cm (319m²);

Në Pallatin nr.30, është parashikuar :

- Shtresë llaç cemento 1:2, t=4cm (285m²);
- Hidroizolim me emulsion 1-karton katrama importi (cilesi e parë) (314m²);
- Shtrese llaç cemento 1:2, t=4cm (512m²).

Shënim :

Për arsye se, llogaritja e volumeve të punimeve, për hidroizolimin e tarracave të pallateve të sipërpërmëndur, është kryer duke verejtur situatën (por pa mundur të verifikohet plotësisht gjendja e shtresave të poshtme, të cilat nuk mund të zbulohen), grupi i punës mendon që në rast se, në përfundim të punimeve do të realizohen volume me të vogla nga ato te parashikuara, pjesa e mbetur e volumeve te kryhet ne vijim ne tarracat e pallateve te tjera te parashikuara per nderhyrje.